



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETAR I UJIT
KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES "VJOSE", VLORE

VENDIM
Nr. 4, Dt. 12.06.2008

Per miratim te lejes, per shfrytezim inertesh ne shtratin e Perroit te Koramit, ne nje mjedis teresisht shtrat perroi, me aluvione te akumuluarra prej vitesh, ne afersi te qytetit Himare (ne verilindje te tij), subjektit "V.M.M.S" sh.p.k, Himare.

Ne zbatim te kerkesave qe percakton Ligji Nr.8093 Dt. 21/03/1996 "Per Rezervat Ujore", konkretisht, neni 8 dhe 20, vendimit nr. 1 dhe nr. 3, dt.21.06.2006, te K.K.U-se, si dhe vendimit nr.2 dt. 07.06.2007 te K.K.U-se, duke gjykuar mbi kerkesen dhe studimin e paraqitur nga subjekti "V.M.M.S" sh.p.k, Himare, konform formularit "E", pasqyruar dhe ne relacionin shoqerues, paraqitur nga A.U.B "Vjose". Keshilli i Basenit Ujembledhes "Vjose",

VENDOSI:

- 1-Te miratoj lejen, per shfrytezim inertesh ne shtratin e Perroit te Koramit, ne nje mjedis teresisht shtrat perroi, ne afersi te qytetit Himare (ne verilindje te tij), Bashkia Himare, Qarku Vlore, subjektit "V.M.M.S" sh.p.k, Himare.
- 2- Siperfaqja e dhene ne shfrytezim (per 3 vjet) do te jete 0.02 km².
E kufizuar nga piketat, me koordinata si me poshte.


X 1 = 44 42 950	Y 1 = 43 94 600
X 2 = 44 43 000	Y 2 = 43 94 550
X 3 = 44 43 400	Y 3 = 43 94 925
X 4 = 44 43 450	Y 4 = 43 94 825
- 3- Leja e shfrytezimit jepet per 3 vjet, deri ne dt. 31.10.2010
- 4- Koha e shfrytezimit te zones do te jete ajo e percaktuar ne vendimin nr.1, dt. 21.06.2006 te K.K.U-se, nga dt.01.06 deri me 31.10, te cdo viti.
- 5- Volumi i materialit qe do te merren per 3 vjet do te jete 30 000 m³, me nje mesatare vjetore 10 000 m³/vit, brenda zones qe jepet ne shfrytezim, thellesia e shfrytezimit deri ne 2 m.

- Vazhdim i Vendimit Nr. 4, Dt. 12.06.2008.

6- Ngarkohet A.U.B “Vjose” per zbatimin e ketij vendimi.

7- Ky vendim hyne ne fuqi menjehere.

PERGJEGJES I A.U.B-se “VJOSE”
VeZir METAJ



KRYETARI I K.B.U “VJOSE”
Xhevair REXHEPI

